



**RREGULLORE PËR MBROJTJE KUNDËR ZJARRIT**

**K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A.PRIZREN**



*Prizren, 2016*

Në bazë të nenit 7. pika 2. e Statutit të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A., dhe Nenit 9, Paragrafit 9.1 të Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 02/L-41, Bordi i Drejtorëve të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. me seli në Prizren, , me datë **25.11.2016** aprovoi këtë :

## **RREGULLORE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI e K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren**

Dispozitat themelore

### **Neni 1**

Me këtë Rregullore për mbrojtjen nga zjarri (në tekstin e mëtejshëm: rregullore) rregullohet organizimi i procesit i cili i ulë rreziqet nga zjarr dhe nëse shpërthen zjarri, pengimin e përhapjes së tij dhe evakuimi i njerëzve dhe pasurisë sipas Planit për evakuim dhe udhëzimeve për veprim në rast të zjarrit, të përcaktuara me këto rregulla. Me këtë Rregullore përcaktohet edhe mënyra e aftësisimit të punëtorëve për ekzekutimin e mbrojtjes nga zjarri dhe detyrimet e punëtorëve të aftësuar për kryerjen e detyrave për mbrojtje nga zjarri edhe të të punësuarve të tjerë.

### **Neni 2**

Mbrojtja nga zjarri, në kuptim të kësaj Rregulloreje, prezanton një sërë masash dhe veprimesh të cilat kompania i ndërmerr për realizimin e qëllimeve nga neni 1. i këtyre rregullave.

### **Neni 3**

Mbrojtja nga zjarri organizohet dhe zbatohet pa ndërprerje në të gjitha objektet e kompanisë, në përputhje me Ligjin, rregulla të tjera dhe me këtë Rregullore.

## **Organizimi i mbrojtjes nga zjarri**

### **Neni 4**

1. Në objektet e Kompanisë, si dhe në hapësirat rreth tyre, zbatohen sidomos këto masa për mbrojtje nga zjarri:
  - 1.1 Objektet duhet të jenë të pajisur me hidrantë, aparate dhe pajisjet tjera të përcaktuara dhe mjetet për fikjen e zjarrit, në pajtim me normat e përcaktuara teknike dhe standardet për mbrojtje nga zjarri.
  - 1.2 Elektroinstalimet, sistemi i ventilimit, burimet e temperaturave të larta, rrufepritësit, kanalizimet dhe instalimet dhe stabilimentet tjera nëpër objekte duhet të vendosen në atë mënyrë që të mos paraqesin rrezik nga zjarri;
2. Pajisjet, mjetet dhe stabilimentet nga paragrafi 1. të këtij neni duhet të kontrollohen dhe të mirëmbahen në gjendje të rregullt për përdorim të duhur, respektivisht në gjendje të plotë funksionale.

#### **Neni 5**

1. Me qëllim të uljes apo eliminimit të rrezikut nga shpërthimi i zjarrit, të gjitha veprimet, procedurat dhe proceset të cilat janë të rregulluara me rregullore apo u nënshtrohen standardeve të detyrueshme duhet të ekzekutohen në pajtim me këto rregulla dhe standarde.

2. Me qëllim të reagimit efikas në rast të shpërthimit të zjarrit, sigurohen hyrjet të papenguara dhe distanca ndërmjet materieve të ndezshme dhe shkaktarëve potencial të zjarrit (burimet e energjisë etj.).

#### **Neni 6**

Në tavane dhe nënkulme të objekteve është e ndaluar mbajtja apo vendosja e çfarëdo materialeve apo pajisjeve, përjashtimisht mbajtjen e aparateve kundër zjarrit. Aparatet, nxehtëset mund të përdoren vetëm nëse janë teknikisht të rregullta.

#### **Neni 7**

Në ambientet e objekteve të kompanisë nuk lejohet të përdoren reshcoat, nxehtëset, radiatorët elektrik, dhe aparate të tjera termoelektrike dhe pajisje të ngjashme për ngrohje (bombola gazi), përveç në dhoma të përgatitura posaçërisht për atë qëllim dhe marrjes së miratimit paraprak nga zyrtari nga neni 11. Paragrafi 2. të kësaj Rregulloreje.

Është e detyrueshme shkyçja e aparateve termoelektrike, pajisjeve dhe mjeteve tjera për ngrohje pas përdorimit të tyre.

#### **Neni 8**

Rrugët hyrëse, hyrjet, daljet, vendkalimet dhe shkallët në objekte gjithnjë duhet të jenë të lira për kalim të papenguar.

Për shënimin e daljes në rast rreziku dhe ndihmës së parë shfrytëzohen shenjat e përcaktuara.

#### **Neni 9**

Puna me materiale të ndezshme dhe kryerja e veprimeve tjera me rrezik zjarri jashtë hapësirave të përcaktuara për veprimtari të tillë, mundë të lejohet vetëm me kusht që paraprakisht të janë marrë masat përkatëse mbrojtëse kundër zjarrit.

#### **Neni 10**

1. Aparatet, pajisjet dhe mjetet e destinuara për fikjen e zjarrit, si dhe aparatet dhe instalimet për njoftim dhe sinjalizim automatik për fikjen e zjarrit, mundë të përdoren vetëm nëse i përgjigjen standardeve ekzistuese momentale, respektivisht nëse janë të pajisura me atest përkatës dhe duhet të mbahen në gjendje të mirë si dhe të mbahet evidenca e rregullt.

2. Aparatet, pajisjet dhe mjetet e destinuara për fikjen e zjarrit vendosen në objektet e kompanisë në vende lehtë të kapshme dhe të dukshme, ku të njëjtat mundë të përdoren vetëm për nevoja të lokalizimit dhe fikjes së zjarrit.

3. Pajisjet për fikjen e zjarrit të cilat përdoren në kompani duhet ti plotësojnë kushtet dhe kërkesat e parapara për fikjen e zjarrit.

### **Personat e aftësuar për mbrojtje nga zjarri**

#### **Neni 11**

Zyrtari i aftësuar profesionalisht për zbatim të mbrojtjes nga zjarri i kryen këto detyra:

- 1) Zbaton masa preventive për mbrojtje nga zjarri të përcaktuara me Ligj, me dispozita tjera dhe këtyre rregullave;
- 2) Rregullisht e kontrollon funksionimin e aparateve për lajmërim automatik dhe fikjen automatike të zjarrit, dhe në rast të mosfunksionimit i ndërmerr masat e nevojshme për pengimin e pasojave të padëshirueshme dhe sjelljen e pajisjeve në gjendje të rregullt;
- 3) Përcakton numrin dhe shpërndarjen e aparateve kundër zjarrit, hidrantëve dhe pajisjeve të tjera, kontrollon rregullsinë e tyre dhe i ndërmerr masat e nevojshme për zëvendësimin e tyre, riparimin, servisimin dhe ndërhyrje të tjera;
- 4) Merr pjesë në përgatitjen e propozimeve të rregullave dhe akteve tjera nga sfera e mbrojtjes nga zjarri, dhe pas miratimit të tyre, i zbaton masat e përcaktuara me këto akte sipas të cilave janë caktuar detyrat.
- 5) Drejtpërsëdrejti kontrollon zbatimin e masave të përcaktuara ose të drejtuara për mbrojtjen nga zjarri dhe në rast të konstatimit të parregullsive apo mangësive të caktuara, për të cilat ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për shpërthim të zjarrit, menjëherë i kërkon ose i sugjeron Udhëheqësit nga paragrafi 2 të këtij neni, mënjanimin urgjent të parregullsive të vërejtura apo ndalimin e punës;
- 6) Merr pjesë në përgatitjen e programit dhe zbatimin e trajnimit bazë të të punësuarve dhe verifikimin e njohurive në fushën e mbrojtjes nga zjarri;
- 7) Rregullisht i raporton udhëheqësit sipas paragrafit 2. të këtij neni për të gjitha dukuritë, ndryshimet dhe problemet nga fusha e mbrojtjes nga zjarri, dhe propozon marrjen e masave konkrete;
- 8) Ndjek rregullat në fushën e mbrojtjes nga zjarri, dhe arritjet teknike nga kjo fushë, dhe në përputhje me të, propozon dhe ndërmerr masat e nevojshme për të përmirësuar mbrojtjen nga zjarri;
- 9) Propozon dhe kontrollon zbatimin masave dhe normave për mbrojtje nga zjarri gjatë adaptimit, rikonstruimit, riparimit dhe servisimit, të cilat kryhen në objekte;

10) Mbanë evidencën e paraparë, dhe,

11) Kryen edhe punë tjera nga fusha e mbrojtjes nga zjarri.

Zyrtari i aftësuar profesionalisht për zbatimin e mbrojtjes nga zjarri, për punën e tij si dhe për kryerjen e detyrave nga paragrafi 1. i këtij neni, i përgjigjet udhëheqësit kompetent të përcaktuar me aktin mbi sistematizimin e vendeve të punës apo me akt tjetër.

### **Neni 12**

Personi në punë për sigurim të objekteve (Rojtari):

1) Gjatë kujdestarisë e viziton objektin, hapësirat, pajisjet dhe instalimet, veçanërisht vendet me rrezikshmëri më të madhe nga shpërthimi i zjarrit, dhe nëse vërehen parregullsi (mangësi) menjëherë ta njoftoj udhëheqësin kompetent si dhe njëkohësisht ti ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e pasojave të padëshirueshme.

2) Kontrollon pajisjet kundër zjarrit në objekt, dhe për mangësitë e vërejtura me kohë e njofton udhëheqësin kompetent dhe ndërmerr masat e nevojshme për gatishmëri të plotë për parandalimin e pasojave të padëshirueshme.

3) I njeh dhe vazhdimisht i përcjellë masat mbrojtëse nga zjarri relevante për objektin në të cilin e kryen kujdestarinë dhe zbaton detyrat tjera të tij të përcaktuara me rregulla dhe dispozita tjera.

5) Rregullisht trajnohet dhe aftësohet profesionalisht në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për këtë qëllim vijon të gjitha kurset e organizuara, seminare, ushtrime dhe forma të tjera të trajnimit, si dhe në mënyrë të pavarur i plotëson njohuritë e veta sipas urdhrave të mbikëqyrësit kompetent.

6) Në kohën e marrjes së detyrës (kujdestarisë) duhet të jetë gjithmonë psikikisht dhe fizikisht i aftë për të kryer detyrat e punës, përndryshe ai mund të largohet nga puna;

7) Ruan, në mënyrë të rregullt e mbanë dhe e përdorë pajisjen personale dhe të përbashkët me të cilën është i ngarkuar, detyrat i kryen me rroba të punës, sillet në mënyrë korrekte ndaj punonjësve dhe palëve në objektet e punës;

8) Me kohë i ndërmerr masat e nevojshme për të mbrojtur objektin ku e kryen kujdestarinë, personelin dhe pasurinë nga avaritë e ndryshme, dëmtimeve dhe aksidente të ngjashme;

9) Për të gjitha mangësitë e vërejtura, ndryshimet dhe problemet në objektin në të cilin kujdestaronë, të cilat mund të rrezikojë sigurinë e objektit, të pronës dhe të personelit pa vonesë e njofton mbikëqyrësin kompetent, ndërsa në rast të mungesës së tij apo nga pamundësia – i njofton personat e tjerë përgjegjës.

## Komisioni për Mbrojtjen nga Zjarri

### Neni 13

Për arritjen më efektive të qëllimeve dhe detyrave për mbrojtjen e njerëzve dhe pronës nga zjarri, kompetent dhe përgjegjës është:

Komisioni për Mbrojtjen nga Zjarri:

1. E monitoron gjendjen organizative, realizimin dhe zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri, inicion dhe drejton masat dhe aktivitetet si dhe përcakton propozime për avancimin e mbrojtjes nga zjarri;
2. Shqyrton gjendjen dhe vendimet e organeve kompetente, propozon masa dhe aktivitete në mënyrë që mangësitë e vërejtura të mënjahen me kohë;
3. E informon organin kompetent mbi çështjet aktuale në fushën e mbrojtjes nga zjarri, paraqet raporte periodike mbi gjendjen e mbrojtjes nga zjarri dhe sugjeron marrjen e masave të nevojshme për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga zjarri.
4. Komisioni përbëhet nga Kryetari, nënkryetari dhe tre anëtar i cili ka për detyrë të merret me shkaqet e zjarrit, analizën dhe planin e veprimit kundër zjarrit.

Për arritjen më efektive të qëllimeve dhe detyrave për mbrojtjen e njerëzve dhe pronës nga zjarri, kompetent dhe përgjegjës janë edhe:

1. Kryeshefi Ekzekutiv;
2. Menaxhmenti i Kompanisë;
3. Zyrtari për Siguri dhe Shëndetin në Punë;
4. Udhëheqësit e objektit;
5. Punëtorët tjerë të Kompanisë.

## Planet për evakuim dhe udhëzimet që duhet të ndiqen në rast zjarri

### Neni 14

1. Në rast të shpërthimit të një zjarri në objektin e Kompanisë, për evakuim të sigurt të njerëzve dhe pasurisë si dhe për të parandaluar përhapjen e zjarrit, veprohet sipas planit për evakuim dhe udhëzimeve për veprim në rast të zjarrit në tekstin e mëtejshëm:

*Plani i evakuimit.*

2. Planin për evakuim e sjell personi përgjegjës në Kompani.
3. Plani i evakuimit ekspozohet në vende të dukshme, në katin përdhës dhe në secilin prej kateve, dhe atë nga një në çdo korridor dhe në afërsi të të gjitha dyerve dalëse.

### Neni 15

1. Plani i evakuimit përbëhet nga pjesa tekstuale përmbajtjen kryesore të të cilit e përbëjnë dispozitat e nenit 16 deri 24 të këtyre rregullave.
2. Plani Evakuimi përbëhet edhe nga pjesa grafike (vizatime) me këtë përmbajtje bazike: renditja e hapësirave; drejtimet e lëvizjes të të rrezikuarve në rast evakuimi të pasqyruara nga shigjetat me ngjyra; numërimi i dhomave, shkallët dhe daljet për evakuim; vende të shenjëzuara dhe të arritshme në të cilat gjenden çelësat nga ato dyer dalje të cilat zakonisht janë të mbyllura.
3. Në pjesën grafike të Planit për evakuim, përveç përmbajtjes nga paragrafit 2 të këtij neni, futen sipas nevojës edhe vendi dhe renditja e pajisjeve zjarrëfikse, hidrantët në murore, elektro-ormanët shpërndarës dhe të dhëna tjera me interes, si dhe legjenda tabela me kuptimet e shenjave dhe simboleve.

### Neni 16

1. Në rast të zjarrit, evakuimin e njerëzve dhe pasurisë dhe parandalimin e përhapjes së zjarrit e organizon dhe, lidhur me këtë, ndërmarrjen e masave të nevojshme ku i e siguron Udhëheqësi kompetent, ndërsa në rast të mungesës së tij, personi kujdestar i caktuar me akt të veçantë.
2. Planet për evakuim, përveç personave të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, e zbatojnë stafit udhëheqës dhe ekzekutiv të kompanisë të hasur në objekte në momentin e shpërthimit të zjarrit.

### Neni 17

1. Për detektimin me kohë dhe reagimin në rast të shpërthimit të një zjarri në objektin e Kompanisë përdoren pajisjet dhe instalimet ekzistuese për fikjen e zjarrit.
2. Punonjësi cili e vëren zjarrin është i detyruar ta fikë atë, e nëse këtë nuk mundë ta bëjë pa e rrezikuar veten apo të tjerët, është i detyruar që për zjarrin ta njoftojë zyrtarin, mbikëqyrësin, njësinë e zjarrfikësve dhe stacionin më të afërt të Plocisë.

### Neni 18

Me evakuimin e njerëzve dhe pasurisë dhe pengimin e përhapjes së zjarrit udhëheq Udhëheqësi i autorizuar, respektivisht Kujdestari, nëse personi përgjegjës nga personi juridik nuk vendos ndryshe, respektivisht deri sa udhëheqjen e aksionit për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë nuk e merr udhëheqësi i njësisë së zjarrfikësve.

Udhëheqësi i aksionit nga paragrafi 1. i këtij neni (në tekstin e mëtejme: **Udhëheqësi i aksionit**) vendos mbi formën e kryerjes së evakuimit, i udhëhequr parasegjithash nga kujdesi që me zbulimin e qëllimit për evakuim të mos shkaktohet ndonjë panik në mënyrë që evakuimi të ekzekutohet me sukses.

Evakuimi kryhet përmes rrugës më të sigurt, duke iu përmbajtur shenjëzimeve për dalje nga objekti.



Në rast shpërthimi të zjarrit në objekt të Kompanisë, pa vonesë merren masat për fikjen e zjarrit, shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë së rrezikuar, ku secili punëtor ka për detyrë:

1. Të lajmërojë udhëheqësin përgjegjës dhe njësitin e zjarrfikësve, e menjëherë me mjetet disponuese të merr pjesë në shuarjen e zjarrit.
2. Të ndërpret me njëherë siguresën automatike për furnizim të energjisë elektrike (nëse ekziston).
3. Derisa zjarri është në kontakt me rrymën elektrike punëtorëve u ndalohet të përdorin ujë për shuarjen e zjarrit.
4. Me arritjen e njësisë së zjarrfikësve të gjithë punëtorët që gjenden në afërsi të zjarrit duhet ti zbatojnë urdhrat e tyre.

#### **Neni 19**

Me të mësuar për shpërthimin e zjarrit ndërmerren këto masa:

1. Udhëheqësi i aksionit jep shenjën e alarmit për fikjen e zjarrit, dhe atë me sinjal zërues apo në formë tjetër, varësisht nga përgatitja e kompanisë.
2. Punëtorët të cilët në kohën e dhënies së alarmit ndodhen në objektin e kompanisë janë të detyruar që menjëherë të vijnë në vendin e zjarrit.
3. Pas ardhjes në vendin e ngjarjes, Udhëheqësi i aksionit e vlerëson situatën dhe vendos lidhur me mënyrën e shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë dhe pengimin e përhapjes së zjarrit, e veçanërisht për evakuimin, llojin e pajisjes dhe mjeteve të cilat do të përdorë dhe mënyrën e fikjes së zjarrit, masat e sigurisë për evakuim dhe fikjen e zjarrit, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, mënyrën e furnizimit me ujë dhe pyetjeve tjera me rëndësi për evakuim dhe pengim të përhapjes së zjarrit.

#### **Neni 20**

Gjatë kohës së zjarrit të gjithë të pranishmit apo punonjësit e ftuar janë të detyruar ti kryejnë urdhrat e Udhëheqësit të aksionit.

#### **Neni 21**

Pas rënies së zjarrit dhe alarmimit ndalohet përdorimi i telefonave fiks në Kompani, përjashtimisht për bisedat rreth gjendjes së krijuar nga zjarri.

#### **Neni 22**

1. Fikja e zjarrit dhe shpëtimi i personave dhe pasurisë kryhet deri në fikjen përfundimtare të zjarrit, respektivisht përfundimit të shpëtimit.



2. Punonjësit të cilët marrin pjesë në fikjen e zjarrit dhe shpëtimin e personave dhe pasurisë e lëshojnë vendin e zjarrndodhjes vetëm pasi që udhëheqësi i aksionit të bindet se zjarri është shuar dhe shpëtimi me sukses është përfunduar.

3. Me përfundimin e shpëtimit dhe intervenimit për ndalimin e përhapjes së zjarrit Udhëheqësi i aksionit nga Kompania ka për detyrë të përpiloj Raport lidhur me rezultatet e evakuimit dhe të ndërhyrjes dhe t'ia dorëzojë atë Zyrtarit për mbrojtje nga zjarri të Kompanisë.

#### **Neni 23**

Aftësimi i stafit për zbatimin e mbrojtjes nga zjarri kryhet përmes trajnimit bazik dhe verifikimit praktik të njohurive në fushën e mbrojtjes nga zjarri, të cilën Kompania e organizon në harmoni me dispozitat e Ligjit.

#### **Neni 24**

Programin e trajnimit bazik të të punësuarve në fushën e mbrojtjes nga zjarri e bie Kompania.

Me përmbajtjen e programit mbi trajnimin bazik të të punësuarve nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri arrihet marrja e njohurive bazë teorike dhe praktike nga:

1. Rregullimit normativ për mbrojtje nga zjarri.
2. Zjarreve.
3. Mbrojtja preventive nga zjarri.
4. Mjetet për mbrojtje nga zjarri.
5. Mjetet dhe pajisjet zjarrfikëse.
6. Taktikat e shuarjes së zjarrit.
7. Përmbajtja e këtyre rregullave, e veçanërisht veprimet e të punësuarve në rast të shpërthimit të zjarrit në objektin e personit juridik, respektivisht evakuimin dhe pengimin e përhapjes së zjarrit.

#### **Neni 25**

1. Verifikimi i njohurive praktike të të punësuarve nga fushën e mbrojtjes nga zjarri bëhet me verifikimin praktik të njohurive.

2. Rreth verifikimit të njohurive të të punësuarve bëhet regjistri dhe mbahet evidenca adekuate.

3. I punësuar i cili në verifikim nuk tregon njohuri të kënaqshme, është i detyruar që në një afat prej 15-30 ditësh nga dita e verifikimit të njohurive ti nënshtrohet verifikimit të sërishëm.

#### **Neni 26**

Me të filluar punën, secili i punësuar duhet të njoftohet me këto rregulla dhe se në afat prej një viti nga data e punësimit është i obliguar për të marrë pjesë në trajnim dhe verifikim të njohurive nga neni 23, 24, dhe 25. të këtyre rregullave.

## Pajisjet teknike dhe mjetet për shuarjen e zjarrit

### Neni 27

Për mbrojtjen nga zjarri kompania duhet ti ketë këto pajisje teknike dhe mjete për fikjen e zjarrit: mjetet e sigurisë dhe pajisjet, aparatet kundër zjarrit dhe pajisjet tjera.

### Neni 28

Për mirëmbajtjen e pajisjeve zjarrfikëse dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit kujdesen punëtorët e ngarkuar me këtë pajisje.

### Neni 29

1. Mjetet për shuarjen e zjarrit duhet të jenë në vend posaçërisht të shënuar, të dukshëm dhe përherë të kapshëm, në të ashtuquajturat pikat e zjarrit, në lokale dhe objekte dhe jashtë tyre dhe të jenë gjithnjë në gjendje të rregullt.
2. Aparatet për shuarjen e zjarrit duhet të kontrollohen çdo 6 muaj me kontroll teknik nga personat e autorizuar në varshmëri me normativat teknike dhe udhëzimet e prodhuesve. Me rastin e kontrollimit mbahet procesverbal në të cilën shënohet se kur është bërë kontrollimi, kush e ka kryer dhe çfarë është vërtetuar nga kontrolli.
3. Servisimi dhe testimi i aparateve për shuarjen e zjarrit do të kryhet tek organizata e autorizuar.

### Neni 30

Lloji i pajisjeve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit dhe vendosja e tyre më për së afërmi përcaktohet veç e veç për secilin objekt në pjesën grafike të Planit të evakuimit sipas nenit 15 të këtyre rregullave.

## Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

### Neni 31

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për mbrojtje nga zjarri Nr. 1096 e datës 01,10,2010 .

### Neni 32

Kjo Rregullore hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga ana e Bordit të Drejtorëve.

Datë: 25,11,2016  
Prizren

K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH. A. – Prizren  
Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve  
  
Rexhep Manxhuka

